

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti :	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi:	Informatikë e Aplikuar
Titulli i lëndës:	Menaxhment dhe ndërmarrësi (për IT)
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	_____
Përshkrimi i lëndës:	<i>Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me mënyrën e menaxhimit, planifikimit, kulturën organizative dhe mjedisin e biznesit dhe kontrollin. Gjithashtu do të njoftohen me ndërmarrësin dhe individin ndërmarrës. Planifikimi i biznesit, mënyra e hartimit të planit të veprimit për ndërmarrjen themeltare, Levat e Planit të biznesit, SWOT analiza, Hartimi i strategjisë financiare, Ideja e profitit, Identifikimi i projeksioneve buxhetore, Sfidat e ndërmarrësis, Ndërmarrësi dhe ndërmarrësia, Format e ndërmarrësis, Identifikimi i mundësive – strategjia e depërtimit në treg për ndërmarrjen, Parashikimi i problemeve, Menaxhimi i riskut, Plani i prodhimit, Plani operativ, Analiza e pikes se rentabilitetit ne ndërmarrje, Sistemi i llogaritaris ne ndërmarrje, Fluksi i keshit ne ndërmarrje.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me konceptet e menaxhimit dhe aftësitë e tyre për zbatimin në praktikë tek bizneset, kompanitë dhe organizatat e tjera. Studentët të njoftohen me ndërmarrësin dhe me procesin e formimit të ndërmarrjes, idetë e ndërmarrësit për te filluar procesin e formimit të subjektit ekonomik.</i>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<i>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të fitojnë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri mbi konceptet teorike mbi menaxhimin dhe mjedisin biznesor te ndërlidhur me planifikimin, organizimin , udhëheqjen dhe kontrollin, • Kuptoj rolin kritik dhe funksionet e menaxherëve dhe zbatimi i saj në organizatë, • Vlerësoj praktikat e menaxhimit në ndërmarrje dhe ti avancoj në një nivel më të lartë. • Analizoj idetë dhe burimet dhe procedurat e themelimit te një ndërmarrje, • Aplikojnë shkathtësitë për hartimin e një plan veprimi ne letër për te ndjekur hapat mbi themelimin e ndërmarrjes,

	<ul style="list-style-type: none"> • Jenë në gjendje që përmes planit investiv të identifikojnë koston dhe profitin në të ardhmen, • Aftësi për të hartuar planin ideor strategjik të fushë veprimtarisë së ndërmarrjes, 		
Parakushtet:	<i>Është e preferuar që studenti të ketë njohuri bazike rreth mjedisit të biznesit dhe terminologjisë së përdorur në menaxhim dhe ndërmarrësi.</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare dhe projektet	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)			
Projektet dhe prezantimet	3	5	15
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi në grupe nga studentet dhe luajtja e roleve, mësim praktik për lenden dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohurit e fituara gjatë ligjëratës.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Studenti mund të zgjedhë për t'u vlerësuar njërin nga dy format e vlerësimit, dhënë më poshtë:</i></p> <p><i>1. Forma 1: Vlerësimi me kollokviume dhe projekt</i></p> <p><i>2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.</i></p> <p>Forma 1:</p> <p><i>Në formën e parë të vlerësimit” Vlerësimi me kollokviume dhe projekt “studenti vlerësohet në katër aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Kollokvium 1 (30%), vlerësim individual</i> <i>2. Kollokvium 2(30%), vlerësim individual</i> <i>3. Aktiviteti në klasë(10%), vlerësim individual</i> <i>4. Projekti (30%), vlerësim grupor.</i> <p><i>Sqarim shtese:</i></p>		

Nëse studenti në secilin aktivitet të mësipërm arrin pikët maksimale, atëherë ai do të vlerësohet me 100 pikë.

Studentët të cilët e kalojnë provimin sipas formës 1 të vlerësimit, lirohen nga obligimi për t'iu nënshtruar provimit final. Vetëm nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t'i nënshtrohet provimit final për të përfituar vlerësim më të lartë.

Forma 2:

Në formën e dytë të vlerësimit” Vlerësimi me provimin përfundimtar”, studenti do t'iu nënshtrohet provimit i cili mbahet pas përfundimit të ligjëratave të lëndës, dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Përmes provimit final studenti maksimalisht mund të arrijë 70% të pikëve nga totali prej 100 pikë.

Pjesa tjetër e pikëve prej 30% duhet të plotësohet nga puna grupore në Projekt, aktivitetet e realizuar gjatë ligjëratave.

Në Kollokvium1, Kollokvium 2 dhe Provim përfundimtar vlerësimi i studenteve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti. Formulari i vlerësimit do të përmbajë pyetje objektive dhe subjektive përmes të cilave do të vlerësohen rezultatet e të nxënësve të studentit:

- Pyetjet objektive do të jenë të llojit: (1) Pyetje me zgjedhje të shumëfishta, (2) E Sakte/ Jo e Sakte, (3) Plotësim dhe (4) Kompozim/ Përputhje; pyetje që do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.*
- Pyetjet subjektive do të jenë të llojit Ese/detyre me shkrim që do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit, nga përgjigjet e hartuara nga studenti ndaj pyetjes së parashtruar.*

Aktiviteti në klasë-nënkupton angazhimin e studentit në trajtim të çështjeve të diskutuara në klase, gjatë ligjëratave.

Projekti (30%), vlerësim grupor: është aktivitet në të cilin studentet zbatojnë në një projekt konkret njohuritë e fituara. Realizohet në grup prej 2 ose 3 studenteve të cilët kanë për obligim ta realizojnë aktivitetin, dokumentojnë edhe prezantojnë para profesorit të lëndës.

	<p><i>Për formën e realizimit dhe dokumentimit të aktivitetit të gjithë anëtarët e grupit do të vlerësohen me pikë të njëjtë(20%), kurse vlerësimi i aftësive prezantuese të aktivitetit është individual dhe përfshinë 10%.</i></p> <p><i>Vlerësimi:</i></p> <p><i>90-100 pikë – vlerësohet me notë 10(dhjetë)</i> <i>80-89 pikë – vlerësohet me notë 9(nëntë)</i> <i>70-79 pikë – vlerësohet me notë 8(tetë)</i> <i>60-69 pikë – vlerësohet me notë 7(shtatë)</i> <i>50-59 pikë – vlerësohet me notë 6(Gjashte)</i> <i>0-49 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim</i></p>
Raporti i teorisë dhe praktikës:	<i>75% teori dhe 25% ushtrime.</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>"Basics of Management" Prof. Dr Berim Ramosaj, Prishtina 2013</i> <i>"Entrepreneurship", Prof. Dr. Safet Merovci, Prishtina 2008</i>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>Rob Yeung: "The rules of Entrepreneurship", 2007</i> <i>Roobins & DeCenzo, Bazat e Menaxhimit, UET, Tiranë, përkthim në gjuhën shqipe.</i> <i>Management: Stephen Robins & Mary Coulter, Prentince Hall, 2007 or later seditions</i> <i>"Emeric Solymossy & Safet Merovci, "Ndërmarrësia", Prishtinë, 2006.</i> <i>"Entrepreneur's Toolkit", Harvard Business Essentials, 2005.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<i>Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndes, Hyrje në teorinë dhe praktikat e menaxhimit Planifikimi i biznesit, mënyra e hartimit të planit të veprimit për ndërmarrjen themeltare,</i>
Java e dytë:	<i>Teoritë e Menaxhimit dhe zhvillimi i tyre</i>
Java e tretë:	<i>Kultura organizative dhe mjedisi biznesor</i>
Java e katërt:	<i>Përgjegjësia sociale dhe etika menaxheriale</i>
Java e pestë:	<i>Marrja e vendimeve dhe teknikat e planifikimi</i>
Java e gjashtë:	<i>Komunikimi dhe IT</i>
Java e shtatë:	<i>Lidershipi dhe kontrolli i menaxhmentit - Testi i dytë,</i>
Java e tetë:	<i>Konceptet kryesore dhe aplikimi në biznes</i>
Java e nëntë:	<i>Levat e Planit të biznesit, SWOT analiza,</i>
Java e dhjetë:	<i>Hartimi i strategjisë financiare,</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Ideja e profitit, Identifikimi i projeksioneve buxhetore,</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Sfidat e ndërmarrësis, Ndërmarrësi dhe ndërmarrësia,</i>

Java e trembëdhjetë:	<i>Identifikimi i mundësive – strategjia e depërtimit në treg për ndërmarrjen,</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Parashikimi i problemeve, Plani i prodhimit,</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Plani operativ, Analiza e pikës së rentabilitetit në ndërmarrje</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	